

Projekte rrjedhëse të financuara nga Banka Europiane Investuese

janar 2022

Emri i projektit	Qëllimi i projektit	Vlera e huasë (milionë euro)	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit
Projekti "Furnizimi me ujë dhe largimi i ujërave të zeza"	Me këtë projekt do të përmirësohen kushtet dhe do të përmirësohet cilësia e jetesës veçanërisht në zonat rurale të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ky projekt është pjesë e politikës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për zhvillim të barabartë rajonal dhe pritet që përmes investimeve në infrastrukturën komunale të stimulohet zhvillimi.	50	2010	2022
Stacioni për pastrim të ujërave të zeza në Shkup	Qëllimi i këtij projekti është trajtimi i ujërave të zeza të mbledhura në Qytetin e Shkupit dhe zonat përreth në përputhje me standardet e përfshira në Direktivën 91/271/KEE për trajtim të ujërave të zeza urbane.	68	2019	2026
Projekt i dedikuar për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ne ndërmarrjeve me kapitalizim të mesëm të tregut	Projekti ka për qëllim sigurimin e kapitalit të ri për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe ndërmarrjet me kapitalizim të mesëm të tregut, me qëllim që të përkrahën projektet e reja, punësimet e reja, rritjen e likuiditetit të ekonomisë dhe rritjen e eksportit.	100	2021	2023
Projekti "Interkonektor për përçimin e gazit natyror Greqi - Maqedonia e Veriut, pjesa e Maqedonisë së Veriut"	Ky projekt ka për qëllim sigurimin e rritjes së shpejtë dhe të qëndrueshme, standardit dhe cilësisë më të lartë të jetesës së qytetarëve. Ky projekt do ta përforcojë veçanërisht bashkëpunimin me Greqinë në fushën e energjetikës dhe do t'i përmirësojë marrëdhëniet diplomatike dhe ekonomike mes të dyja vendeve, duke ofruar një shembull kontrakt për besim reciprok në sektorin strategjik.	28,9	2021	2025